



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS**  
**KOMISIONI INSTITUCIONAL I ZGJEDHJEVE**

Nr. 89 Prot.

Tiranë, më 10 / 01 / 2023

**VENDIM**  
**Nr. 2 , Datë 10.01.2023**

**PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN E KOMISIONIT INSTITUCIONAL I ZGJEDHJEVE Nr. 11, DATË 14.12.2022 “PËR ORGANIZIMIN DHE ZHVILLIMIN E PROCESIT TË PËRZGJEDHJES SË TRI KANDIDATURAVE ME TE VOTUARA NGA STUDENTET PËR ANËTARIN E BORDIT TË ADMINISTRIMIT TË UNIVERSITETIT TË SPORTEVE TË TIRANËS, PËRFAQËSUES TË STUDENTËVE”,**

Komisioni Institucional i Zgjedhjeve të Universitetit të Tiranës, në mbështetje të neneve 47 dhe 48 të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL-së në Republikën e Shqipërisë”, të pikës 6 të VKM nr. 782, datë 26.12.2018 “Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të Bordit të Administrimit, përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për arsimin, në institucionet publike të arsimit të lartë”, të Vendimit të KIZ nr. 11, datë 14.12.2022 “Për organizimin dhe zhvillimin e procesit të përzgjedhjes së tri kandidaturave për Anëtarin e Bordit të Administrimit të Universitetit të Sporteve të Tiranës, përfaqësues të studentëve”, me qëllim zhvillimin e procesit të përzgjedhjes së tri kandidaturave më të votuara për Anëtarin e Bordit të Administrimit të UST-së, përfaqësues të studentëve, në vlerat e së drejtës, barazisë dhe të transparencës së këtij procesi:

**VENDOSI;**

1. Pas pikës 7 të Vendimit të KIZ nr. 11, datë 14.12.2022 “Për organizimin dhe zhvillimin e procesit të përzgjedhjes së tri kandidaturave më të votuara për anëtarin e bordit të administrimit të universitetit të sporteve të Tiranës, përfaqësues të studentëve”, shtohen pikat 7.1 , 7.2 dhe 7.3 me përmbajtjen si vijon:

“7.1. Çdo kandidat pjesëmarrës në procedurën për përzgjedhjen e tri kandidaturave për anëtarin e Bordit të Administrimit të Universitetit të Sporteve të Tiranës, përfaqësues të studentëve, të shpallur me Vendimin e KIZ nr. 14, datë 28.12.2022, ka të drejtën të caktojë 1 (një) përfaqësues për vëzhgimin e procesit dhe të rezultatit të votimit që do të zhvillohet më datën 12.01.2023”.

“7.2. Kandidati, për përcaktimin e përfaqësuesit të tij për vëzhgimin e procesit dhe të rezultatit të votimit, depoziton në KIZ autorizimin e nëshkruar nga kandidati dhe ku përcaktohet qartë emri/mbiemri i përfaqësuesit të tij shoqëruar me dokumentin e identifikimit”.

“7.3. Kandidati mund mund të jetë prezent vetëm në procesin e nxjerrjes së rezultatit të votimit” që fillon në orën 17:00 te ditës së votimit.

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të UST-së.

**Komisioni Institucional Zgjedhor**

**DENIS NURIU**  
Kryetar

